

JURIDIK I PËRGJITHSHËM - VITI I KATËRT- SEMESTRI VII

Kriminologjia [O]:

Qëllimi i kësaj lënde është, që studentët të aftësohen për dukuritë e kriminalitetit, mënyrat e shfaqjes dhe format e tij, dukuritë dhe rrënjët e krimit, të shohin teoritë mbi kriminalitetin dhe lidhjet me shkencat tjera penale. Shpjegon faktorët e kriminalitetit siç janë: kriminaliteti i dhunës, kriminaliteti politik, ekonomik, i organizuar, prostitucioni, etj.

E Drejta e Punës [O]:

Qëllimet e kësaj lënde janë që studentët të pajisen me njohuritë e duhura mbi detyrimet dhe përgjegjësitë, në marrëdhëniet e punës, si dhe me institucionet juridike nga lëmia e punës, procedurat e punësimit, lidhjen e kontratave për punësim, realizimin dhe mbrojtjen e të drejtave nga marrëdhënia e punës te punëdhënësi dhe nga organet kompetente, përgjegjësitë e të punësuarve, pushimet e marrëdhënieve të punës, etj.

Financat dhe e Drejta Financiare [O]:

Qëllimi i kësaj lënde është, që studentët të njohohen mbi financat dhe të drejtat financiare që shteti dhe institucionet tjera juridike-publike i sigurojnë mjetet, mënyrat e mbledhjes së të hyrave publike, ndarjes dhe shpenzimeve të këtyre mjeteve si dhe kontrollimi nga institucionet e brendshme dhe të jashtme se si janë shpenzuar ato.

Shkrim Akademik dhe Metodologji Hulumtimi [O]:

Qëllimi i kësaj lënde është, që studentët të aftësohen thellësisht në të shkruarit akademik, metodat e studimit, punimet profesionale, rregullat metodologjike për hartimin e punimeve profesionale, llojet e punimeve profesionale, hapat kryesorë të hartimit, pjesët e punimit, fusnotat, burimet bibliografike, etj.

E Drejta e Pronës Intelektuale [Z]:

Qëllimi i kësaj lënde është, që studentët pas përfundimit të këtij kursi, të jenë në gjendje të kuptojnë të drejtat e një prone intelektuale duke përfshirë të drejtën e përdorimit, kopjimit, etj. Studentët do të aftësohen në mbrojtjen e të drejtës intelektuale të bizneseve, të njohohen me aktet ligjore që mbrojnë këto prona, mbrojnë të drejtat autoriale dhe intelektuale, etj.

Zgjedhja Alternative e Mosmarrëveshjeve [Z]:

Qëllimi i kësaj lënde është, që studentët të aftësohen në çështjet që kanë të bëjnë me zgjedhjet alternative të mosmarrëveshjeve. Këto zgjidhje janë mjete të zakonshme për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve më shpejtë dhe në mënyrë më efektive sesa zgjidhja e mosmarrëveshjeve në gjykata. Këto zgjidhje kanë edhe kostot më të ulta, më efektive.

E Drejta e Konkurrencës [Z]:

Qëllimi i kësaj lënde është, që t'i përgatis studentët që pas përfundimit, të njohohen me të drejtat e konkurrencës, të njohohen mbi veprimtaritë konkurruese, dispozitat juridike që rregullojnë tregtinë, akti i konkurrencës, komisionin e konkurrencës së Kosovës, detyrat, kompetencat dhe funksionet. Studentët do t'i shohin detyrat e përgjithshme, dënimet, avokimet e konkurrencës, gjykimet e rëndësishme të gjykatës supreme, etj.

JURIDIK I PËRGJITHSHËM - VITI I KATERTË - SEMESTRI VIII

Penologji [O];

Qëllimi i kësaj lënde është, që studentët të aftësohen me nocionet e penologjisë, parimet themelore të penologjisë, tipet e ekzekutimit të sanksioneve penale, institucionet penitenciare për ekzekutim të sanksioneve penale, të drejtat dhe detyrat e personave gjatë vuajtjes së sanksioneve penale, të vlersojnë kompetentësinë dhe sistemin penitenciar. Të zbatojnë metodat dhe mjetet bashkëkohore në procesin e risocializimit dhe riintegritimit të personave të dënuar dhe parandalimin e kriminalitetit në përgjithësi.

Viktimologji [O]:

Qëllimi i kësaj lënde është, që studentët të njohohen me fushën e viktimologjisë, parimet e saj, metodat e viktimologjisë, burimet themelore të viktimologjisë, marrëdhëniet e viktimologjisë me fushat tjera juridike, karakteristikat dhe cilësitë e viktimës dhe aspektet tjera viktimologjike.

E Drejta e Procedurës Penale – pjesa e posaçme [O]:

Qëllimi i kësaj lënde është, që studentët të aftësohen në parimet kryesore të procedurës penale, pjesa e posaçme, marrëdhëniet juridike procedurale penale, palët me procedura penale të posaçme, kompetencat e gjykatës në procedurën e posaçme, ti shohin thirrjet në gjyq dhe shpenzimet gjyqësore që janë veprime të karakterit procedural gjyqsor.

Punimi i diplomës dhe praktika: 10 ECTS